

Udhëzues praktikë për prindër/mësimdhënës për **TikTok**




Udhëzuesi përdor pamje reale të aplikacionit dhe shpjegime të shkurtra poshtë tyre.



TikTok: Siguria dhe kontrolli prindëror

Përdorni Family Pairing për ta lidhur llogarinë e prindit me llogarinë e fëmijës dhe për të menaxhuar kohën, përmbajtjen dhe privatësinë.

Bisedoni me fëmijën para se t'i ndryshoni cilësimet. Kontrollat funksionojnë më mirë kur shpjegohet pse po përdoren.






1

Hapni cilësimet

Hapi 1 Në telefonin e prindit, hapni TikTok dhe shkoni te **Profile**.

Hapi 2 Prekni menunë me tri vija ≡ në këndin e sipërm.

Hapi 3 Zgjidhni **Settings and privacy** (Cilësimet dhe privatësia).



2

Lidhni llogaritë me Family Pairing

Hapi 1

Në **Settings and privacy**, lëvizni poshtë dhe prekni **Family Pairing**.

Hapi 2




Prekni **Continue** dhe zgjidhni rolin **Parent**.

Hapi 3

Dërgojani fëmijës lidhjen ose shfaqni kodin QR.

Hapi 4


Në telefonin e fëmijës, hapni të njëjtin seksion, skanoni kodin ose hapni lidhjen dhe konfirmoni **Link accounts**.



3

Vendosni kufirin e përdorimit

- Hapi 1** Në **Family Pairing**, zgjidhni llogarinë e fëmijës.
- Hapi 2** Hapni **Screen time** → **Daily screen time**.
- Hapi 3** Prekni **Set screen time limit**, caktoni kohën për secilën ditë dhe ruajeni.
- Hapi 4** Përdorni edhe **Schedule time away** për orarin e mësimet, detyrave ose gjumit.



4

Kufizoni përmbajtjen e papërshtatshme

Hapi 1

Nga llogaria e fëmijës në **Family Pairing**, hapni **Content preferences**.

Hapi 2



Aktivizoni **Restricted Mode** për të kufizuar përmbajtjen që mund të mos jetë e përshtatshme.

Hapi 3

Te **Filter keywords**, shtoni fjalë ose tema që dëshironi të shfaqen më rrallë.

Hapi 4

Kontrolloni edhe **Privacy and safety**: mbajeni llogarinë private dhe kufizoni mesazhet e kontaktet e padëshiruara.



5

Menaxhoni gjumin dhe njoftimet

Hapi 1

Në **Family Pairing**, zgjidhni llogarinë e fëmijës dhe hapni **Push notification schedule**.

Hapi 2


Aktivizoni **Set a schedule** dhe caktoni orarin kur njoftimet duhet të jenë të çaktivizuara, për shembull gjatë mësimet ose natës.

Hapi 3

Për kujtesën e gjumit, në telefonin e adoleshentit hapni **Settings and privacy → Screen time → Sleep reminders**.

Hapi 4

Prekni **Set up**, zgjidhni orën e fillimit dhe ruajeni. Për llogaritë e adoleshentëve, ora e përfundimit vendoset automatikisht tetë orë pas orës së fillimit.



6

Mbroni privatësinë dhe kufizoni kontaktet

Hapi 1

Në **Family Pairing**, zgjidhni llogarinë e fëmijës dhe hapni **Privacy and safety**.

Hapi 2

Aktivizoni **Private account** dhe çaktivizoni **Suggest your teen's account to others**.

Hapi 3


Te mesazhet direkte, komentet dhe përmendjet, zgjidhni **Friends** ose **No one**, sipas moshës dhe nevojave të fëmijës.

Hapi 4

Rishikoni edhe kush mund t'i shkarkojë videot ose ta ripërdorë përmbajtjen për **Duet** dhe **Stitch**.

Hapi 5

Edhe kur llogaria është private, fotografia e profilit, emri i përdoruesit dhe përshkrimi mund të jenë të dukshme; mos vendosni të dhëna personale në to.



7

Blokonti dhe raportoni llogaritë problematike

Hapi 1

Në **Family Pairing**, zgjidhni fëmijën dhe prekni **Manage blocked accounts**.

Hapi 2

Prekni + **Block accounts**, kërkoni llogarinë dhe konfirmoni **Block account**.

Hapi 3


Te një video problematike, prekni **Share → Report**, zgjidhni arsyen dhe dërgoni raportimin.

Hapi 4

Për të raportuar një përdorues, hapni profilin e tij, prekni ikonën **Share** dhe zgjidhni **Report** ose **Block**.

Hapi 5

Bisedoni me fëmijën për bllokimin, në mënyrë që edhe ai ose ajo të mësojë të përdorë vetë mjetet e sigurisë.



8

Rifreskoni “For You feed”

Hapi 1 Në llogarinë e adoleshentit, hapni **Profile** → ☰ → **Settings and privacy**.

Hapi 2 Zgjidhni **Content preferences** → **Refresh your For You feed**.

Hapi 3 Ndiqni udhëzimet dhe konfirmoni rifreskimin. Ky veprim nuk mund të zhbëhet.

Hapi 4 Përdoreni kur rekomandimet janë mbushur me përmbajtje shqetësuese, mashtruese ose dezinformuese. Pas rifreskimit, ndërveprimet e reja do të ndikojnë në rekomandimet e ardhshme.

Kontroll i shpejtë për prindër / mësimdhënës

-  Shpjegojini fëmijës të mos publikojë adresë, numër telefoni, shkollë ose vendndodhje.
-  Për përmbajtje fyese ose të rrezikshme: prekni **Share → Report**; për përdorues të dyshimtë përdorni **Block**.
-  Ruani prova me pamje ekrani kur ka kërcënim, shantazh ose ngacmim dhe njoftoni një të rritur përgjegjës.